

**Ndryshimet e paradigmës në albanologji dhe pasqyrimi i tyre në mitet
shtetformuese në Shqipërinë komuniste – ‘Rasti Buda’**

*„[...] et dixit illis angelus
nolite timere [...]“*

(Lucas 2, 10)

Objekt i këtij studimi në formë kumtese, kushtuar Jubilarit tonë, është në thelb ‘Çështja Shqiptare’. E meqë kjo ‘çështje’ është shndërruar ndërkohë në një madhësi variabël në diskursin intelektual shqiptar, duke kapluar me rëndesën dhe rëndësinë e saj aktuale kryesisht jetën sociale, politike dhe ekonomike brendapërbrenda hapësirës kompakte shqipfolëse në Ballkan – pra ndikon si e tillë edhe në koniunkturën ndërkombëtare –, na duhet të ndërhyjmë fillimisht me sqarimet e rastit, se objekti i kumtesës sonë ngërthen natyrshëm pikërisht atë variant të mëhershëm e të patëkeq të këtij koncepti, i cili ruan gjithherë mëvetësinë e tij brenda kornizës shkencore-albanologjike e vetëm si i tillë (duke u kufizuar këtu në emra studiuesish dhe intelektualësh shqiptarë e arbëreshë):

- a) nxiti në zanafillë kureshtjen intelektuale lidhur me prejardhjen dhe (para)historinë e popullit shqiptar: shek. XIV-XVI: Gjon Gazulli, Marin Biçikemi vs. Barleti etj.;
- b) duke i vënë natyrshëm shpërgënjtë mendimit intelektual-albanologjik në shek. XVII-XVIII deri në gjysmën e parë të shek. XIX: Pjetër Mazreku, Frang Bardhi, Giorgio Guzzetta (= Àt Gjergj Guxeta), Gjon P. Nikollë Kazazi, Paolo Maria Parrino (= Àt Pal Maria Prifti), Nicolò Chetta (= Àt Nikollë Keta), Angelo Masci (= Engjëll Mashi), Vincenzo Dorsa (= Vinçenc Dorsa) etj.;
- c) përkatësisht duke e orientuar atë prej gjysmës së dytë të shek. XIX drejt gjurmimit retrospektiv-sistematik të gjithë atyre shënjesve themelore që ngërthejnë së bashku matriksin e kulturës etnike të popullit shqiptar përgjatë zhvillimit të saj në kohë e hapësirë: Konstandin Kristoforidhi, Girolamo de Rada (= Jeronim de Rada), Demetrio Camarda (= Àt Dhimitër Kamarda), Pashko Vasa, Sami Frashëri, Shtjefën Gjeçovi, Ndre Mjeda etj.; ndër të tjera:
 - origjina e shqiptarëve, parë këta si një bashkësi etnike-kulturore e gjuhësore e mëvetësishme;
 - territori i tyre anas, parë ky si ‘atdhe historik’, në mos edhe ‘zanafillës’, që vjen me thënë ‘(para)antik’ vs. ‘mitik’;
 - gjuha burimore shqipe, si mjet komunikimi i gjithëshëm brenda kësaj bashkësie;
 - mënyra tradicionale e jetës materiale krahas asaj shpirtërore në po këtë bashkësi: doket, zakonet, folklori etj.;
 - botëkuptimi/besimi tradicional si madhësi variabël në kohë e hapësirë, sipas rastit: pagan, i krishterë (= katolik-romak ~ ortodoks) vs. muhamedan etj.;

- trashëgimia kulturore-historike (edhe) në gjuhën amtare (Biçikemi vs. Barleti, Gazulli, Buzuku, Matranga, Budi, Bardhi, Figlia, Brancati, Chetta, Kazazi, Anonimi i Elbasanit, Kostë Berati etj.)

Prashtu jemi fokusuar në këtë parashtrësë në atë kompleks tematik, të cilit lejohemi t'i veshim tash figurën metaforike *Nyjë e Gordonit* në shkencat historike albanologjike e që si e tillë kushtëzoi e mundësoi dikur (shek. XIX-XX) përfitim e vetë albanologjisë si shkencë komplekse rajonale. Me fjalë të tjera, bëjmë fjalë për atë 'Çështje Shqiptare' që shoqëron a mëton të shoqërojë ende sot e gjithë ditën diskursin albanologjik në ato rrethe shkencore-intelektuale, të cilat janë të interesuara drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në hetimin induktiv-rezultativ të njërit apo tjetrit identifikator, sindëkur të vetë matriksit të kulturës etnike-gjuhësore shqiptare në tërësinë e tij.

Asgjëmangut, në bashkëlidhje me këtë objekt studimi, syzimi ynë vatërzohet gjetkë, e këtë jemi rrekur ta qartësojmë bash në titullin e kumtesës sonë, ku dalin në pah së pari ato ndryshime themelore në paradigmen e metodës së kërkimit diakronik në albanologjinë shqiptare:

- a) bash ashtu siç i përjetoj sidomos debati intelektual shqiptar gjatë hetimit të kësaj 'çështjeje', kryesisht përgjatë gjysmës së dytë të shek. XIX dhe fillimeve të shek. XX e që përkon, thënë më saktë, bëhet pjesë integrale e programit kulturor-ideologjik të Lëvizjes shtetformuese të Rilindjes Kombëtare Shqiptare;
- b) që u formëzua dhe rikonfigurua në vazhdimësi gjatë shek. XX, duke sendërtuar atë mozaik mitik- vs. historik-kulturor, që veshi fasadën ideologjike nacionaliste të disa formacioneve shtetërore (të paktën) në një pjesë të hapësirës kompakte shqipfolëse (Shqipëri), përkatësisht më vonë atë të lëvizjeve nacioniste shtetformuese në Kosovë e gjetkë; e
- c) që vijon të gjëllijë deri në ditët tona në vazhden e tranzicionit intelektual shqiptar, bash në një periudhë, kur debati shkencor-albanologjik përjeton një ngërç në formën e krizës së mirëfilltë, sa mizore aq edhe vrastare në rrethet intelektuale shqiptare, pasi janë katandisur si mos më zi e si mos o Zot (!!!) qoftë aktivitetet serioze albanologjike, ashtu edhe vetë angazhimi e orientimi social-kulturor po aq serioz në kërkimin diakronik albanologjik.

Në rast se ngjërojmë tash ato pak studime kritike bashkëkohore që 'guxojnë' të venë gishtin në plagë e të mëtojnë përgjithësime sintezë të paktën të karakterit historiografik, vërejmë – sigurisht, pa pasur ndërmend assesi me ndërmarrë një krehje ballore të prurjeve kësodore deri sot (!) –, që në to boshti kronologjik i hulumtimit, edhe sa i përket kësaj 'çështjeje', segmentohet në tri periudha bazë, sinorët kohorë të cilave përkojnë deri diku me njëra-tjetrën, anipse secili studiuës u vesh sipas nevojës e rastit emërtime të ndryshme, ase ndërmerr ndarje dytësore brenda njëres a tjetres periudhë. Pa hyrë aspak në hollësi e detaje të kësaj natyre, vëmë oroe, sa vijon:¹

¹ Për ato pak studime me karakter përgjithësues historiografik, të botuara deri në fillimet e shek. XXI, shih së fundi Schmitt (2005 143/shën. 1), ku ndër studiuës të tjerë shqiptarë të kohës sonë feks emri i Valentina Dukës: Ten Years of Post-Communist Historiography in Albania. Reflektions on the Past in

1. Periudha e parë rrok në vetvete zanafillën e diskursit historik albanologjik / shqiptar, sidomos atë fazë prej gjysmës së shek. XIX e deri në vitet 1944/5, që pagëzohet sipas rastit ose si joekzistuese (Schmitt 2005 144²); ose – sidomos prej gjysmës së shek. XIX – si një periudhë e mbështjellë me rubën *romantike-nacionaliste* (Egro 2007 30);
2. Periudha e dytë e viteve 1944/5 – 1990, parë kjo si *periudhë politike komuniste*, përkatësisht ajo e *shkencës hoxhashqiptare* (Schmitt 2005 144v.: “Hoxhaalbanische Wissenschaft”), nëmos ajo *komuniste*, përkatësisht *totalitare-unitariste* (Egro 2007 30vv.);
3. Periudha e tretë, ajo pas vitit 1990 e që vijon sot e gjithë ditën, së cilës edhe pse i vishen cilësime pa konotacion të mirëfilltë negativ, si p.sh. *postkomuniste* (Schmitt 2005; Egro 2007 30), bëhet edhe në këto shkrime më se e qartë se është një *periudhë tranzicioni shkencor-intelektual* shqiptar me tipare më fort negative se sa pozitive, bash kur në Shqipëri përjetojmë atë ngërç, përkatësisht shturje thujtë të infrastrukturës së kërkimit shkencor, sikurse përgjithësisht të vetë studimeve diakronike në albanologji, pra edhe në ato historiografike shqiptare.

Në vëzhgimet tona, të realizuara me rastin e këtij tubimi, jemi orientuar kryesisht në ato prurje rezultative-koherente të shkencave historike shqiptare në periudhën e dytë, shi në atë më të brishtë, bash në hetimin shkencor të ‘Çështjes Shqiptare’ gjatë gjysmës së dytë të shek. XX, kur kjo ‘çështje’ erdhi e u bë jo thjesht dhe vetëm objekt kryesor i diskursit shkencor albanologjik në hapësirën kompakte shqipfolëse, por zuri vend si e tillë edhe në programin nacionalist, kulturor-ideologjik të propagandës shtetërore të regjimit komunist në Shqipëri – duke hasur si e tillë shumëkund paralele në shkencat historike shoqërore të vendeve të Europës Juglindore, qofshin këto komuniste (: ish-Jugosllavi, Rumani, Bullgari, Hungari) ose jokomuniste (: Greqi).

Tash – plot 25 vjet pas zbythjes së atij regjimi – jemi të gjithë më se të ndërgjegjshëm, thënë më saktë, tejet të ndërgjegjësuar se kemi të bëjmë në këtë rast me një periudhë thujtë gjysmëshekullore, kur në Shqipëri sundoi një regjim totalitar, i cili ushtroi dhunën e vet strukturore në të gjitha aspektet e jetës materiale e shpirtërore në Shqipërinë e Pasluftës (së Dytë Botërore) e si i tillë, sidomos në fazën e fundit të gjallesës së vet (vitet ’70 - ’80), u rrek të diktojë edhe orientimin e mendimit historik-albanologjik shqiptar drejt unitarizimit pa kushte, pra – në rastin më të keq (!!!) – drejt konformizimit të shumëkërkuar ndërmjet shkencës dhe politikës, që vjen me thënë miratimit *en bloc* si të mirëqenë të një tube tezash fikse me rezultate të

the 90-ies; në: Klio ohne Fesseln? Historiographie im östlichen Europa nach dem Zusammenbruch des Kommunismus. (Hrsg. Alojz Ivanisević et al.) Wien 2002, 513-520. Shih edhe Egro 2007.

² Pa dashur aspak të tjerim gjerë e gjatë, sikurse lart e poshtë, arsyet dhe motivet që e nxisin Schmitt-in të syzojë këtë përfundim, lejohe mi të citojmë këtu vetëm gjykimin e tij përfundues, tejkshuar si e zeza mbi të bardhë, sa vijon: “Das Jahr 1945 bedeutete daher für die albanische Wissenschaft keinen Neuanfang, sondern den eigentlichen Beginn ihrer Existenz.” (: 2005 144 = shq. “Andaj viti 1945 nuk parakuptonte për shkencën shqiptare aspak një rifillim, por vetë fillimin e mirëfilltë të ekzistencës së saj.”)

paracaktuara në shkencat historike albanologjike shqiptare, të cilat legjitimonin së bashku qoftë edhe *ad hoc* atë paketë kontrolluese ideologjike të propagandës shtetërore me theks të fuqishëm nationalist, në të cilën vendin kryesor e zinin e do të zinin do direktiva të natyrës aksiomatike, ndër të tjera:

- a) Shqiptarët janë autoktonë den-baba-den në trojet e tyre historike.
- b) Hapësira e sotme kompakte shqipfolëse në Gadishullin Ballkanik është thjesht një truall restriksioni, pra jo-ekspansioni në rrjedhën e zhvillimit kulturor-historik e demografik të etnogjenezës shqiptare; çka tumir vetiu në instancë të fundit:
- c) si bashkëlidhjen e pandërmjetme ashtu edhe vijimësinë gjenetike 'legjitime' të etnosit historik shqiptar me të ashtuquajturin etnos ilir, në të cilin rrokeshin e rroken sipas rastit një numër entitetesh etno-kulturore anase në perëndim dhe qendër të Ballkanit antik, të tilla si: etnosi dardan, përkatësisht ai maqedonas, e padyshim – dale-dale (!!!) – edhe ai epirot.

Po pellazgët?! Një përpjekje ogurzezë, që ndërmori Diktatori i Madh dora vetë³ e që do t'i vinte vërtet kapak vorbullës mistike që mbrohej (e mbrohet ende sot?) nga shteti, ishte bash direktiva e tij për një angazhim sa abstrakt të masave që 'bëjnë shkencën', aq edhe konkret të studiuesve historianë, arkeologë, gjuhëtarë e antropologë shqiptarë që 'prodhojnë shkencë' me parë mundësitë e hedhura me bojë të zezë në letër të bardhë një bashkëlidhje gjenetike qoftë edhe të ndërmjetshme mes etnosit gjuhësor-kulturor shqiptar dhe atij pellazgjik, si njëri ndër më lashtët, nëmos më i hershmi në rajonin e Mesdheut.⁴

Duke bërë këtë sqarim të parë e më se të domosdoshëm, lejohemi të qartësojmë ndërkaq edhe bashkëlidhjen e temës së kumtesës sonë me tematikën kryesore të vetë këtij tubimi, që i përkushtohet historianit dhe antropologut të mirënjohur shqiptar në këtë vit të tij jubilar. Dhe është fakt që profesor Aleks Buda e vatërzoj qysh në të ri në analizat e veta historike-antropologjike edhe 'Çështjen Shqiptare'; madje nuk mëkatojmë aspak, në rast se i mëshojmë fort kësaj rrethane, në kuptimin që aspekte të tëra të kësaj çështjeje Jubilari ynë i nisi e i stolisi në vazhdimësi në gjallje të vet, anipse si pinjoll i elitës intelektuale shqiptare përgjatë gjithë gjysmës së dytë të shek. XX – siç rezulton edhe prej shkrimeve të tija të mirëfillta shkencore – nuk mëtoi kurrherë të ishte qoftë edhe *primus inter pares* në ato rrethe intelektuale shqiptare të kohës, ku pjesëmerrte në mënyrë aktive.

Lejohem t'i mëshoj fort kësaj përsiatjeje vetjake – sado provokuese e me theks logjik anashkalues që mund të tingëllojë në pamje të parë (!) –, pas gjase i yshtur edhe

³ Kumt i dhënë prej tij në një takim me përfaqësues të BRPSH-së rreth vitit 1970, pasi kishte lexuar një libër diturak në frëngjisht me autor studiuesin dështak Zacharie Mayani. Hollësisht për këtë Vebiu (2007).

⁴ Kjo tezë në formë përsiatjeje qoftë edhe diletanteske, në mos gabojmë, nuk u ngërthye atëbotë aspak në 'pllanet' afatgjata të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, përkatësisht në institucionet e saja albanologjike. Por ja që vërejmë në kohën tonë të na shfaqet më se seriozisht, thënë më saktë tamam si kërpudha pas shiut, ndër të tjera te historiani më prodhimtar në periudhën e tranzicionit intelektual shqiptar. (Frashëri 2008 5vv). Për problemin fiktiv pellazgjik dhe marrëdhëniet e shqipes me gjuhë të hershme e pak ose aspak të njohura të Ballkanit dhe Mesdheut antik shih së fundi Sh. Demiraj (2008).

nga një rrethanë e dytë, por aspak dytësore, sa i përket konstatimit që Jubilari ynë nuk e jetoi jetën e vet intelektuale thjesht dhe vetëm si studiues historian e antropolog i përkorë në albanologji, por edhe, madje sidomos, si bartës në vazhdimësi i një numri funksionesh kyçe administrative në infrastrukturën e kulturës, arsimit dhe të kërkimit shkencor në Shqipëri përgjatë gjysmës së dytë të shek. XX. Funksioni i tij i fundit e më jetëgjati ishte bash ai i kryetarit të Akademisë së Shkencave të (Republikës Socialiste të) Shqipërisë (1972-1989, *pro forma* deri më 1993, edhe pse kishte zënë përfundimisht shtratin, duke i dhënë fund *de facto* karrierës së tij profesionale.)

Kësaj rrethane pozicionimi bifunksional: si aktivitet intelektual dhe angazhim social, të cilin lejohemi ta cilësojmë tash patëkeq si 'Rasti Buda', sekush mund t'i bashkojë sipas mundësive të veta njohëse një tubë aspak të vogël studiuesish të tjerë shqiptarë që i takonin bash kësaj elite intelektuale-shkencore, sidomos në atë fazë të parë të periudhës së dytë (: vitet '50 – '70), e që u aktivizuan në mënyrë intensive edhe me 'Çështjen Shqiptare', emra të tillë si: Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej, Mahir Domi, Hasan Ceka, Skënder Anamali, Osman Myderrizi, Shaban Demiraj, Selim Islami, Qemal Haxhihasani etj. Kemi të bëjmë pra me një rreth elitar studiuesish shqiptarë të asaj kohe, të formuar kryesisht në Perëndim (d.m.th. para Luftës së Dytë Botërore) ose, ja ashtu: me dëshirë e vullnet e mirë, pra thjesht në mënyrë autodidakte; bash në Shqipëri, pikërisht në atë vend, "ku u kishte rënë koka" (A. Z. Çajupi). Dhe është fakt që prurjet shkencore-intelektuale të kësaj aradhe studiuesish elitarë përkrijnë jo rastësisht pikërisht me fazën e parë të kësaj periudhe të dytë, të ashtuquajtur *komuniste* ase *totalitare-unitariste* në historiografinë shqiptare e në shkencat historike albanologjike në përgjithësi, anipse këta elitarë në shumësinë e tyre nuk e përjetuan as atë 'fat' të ishin a të detyroheshin të ishin anëtarë të Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Asgjëmangut, fakt i pakundërshtueshëm është gjithashtu që bash në këtë periudhë të dytë, sidomos në fazën e saj të fundit (vitet '70 – '80), përjetojmë vërtet aso rrethanash, kur mozaikun kulturor-historik vs. -mitik të ideologjisë shtetërore nacionaliste e kaploi i ashtuquajturi 'delir i iliromanisë' në vlerësimin qoftë edhe kritik-shkencor të të gjitha prurjeve albanologjike, sa i përket hulumtimit retrospektiv të kulturës etnike-gjuhësore shqiptare. Bëjmë fjalë këtu për një fazë që përkon me atë dhunë strukturore të zakonshme që ushtroi aparati i propagandës shtetërore të regjimit në fuqi, duke diktuar – siç prekëm më lart – një politikë totalitare-unitariste edhe ndaj kërkimit shkencor diakronik (sikurse edhe formimit shkollor-universitar), përkatësisht duke e orientuar atë thjesht dhe vetëm në vëzhgimin, qëmtimin dhe përcjelljen e atyre argumenteve dhe dëshmimeve me karakter mohues e pohues, pra pozitiv, që vjen me thënë vetëm e shfajësonin ase mbarështonin mozaikun kulturor-historik vs. -mitik kombëtar, kumti i të cilit tingëllonte as më shumë e as më pak, pra thënë troç, si vijon: *matriksi i kulturës etnike-gjuhësore shqiptare dëshmon në të gjithë identifikatorët e tij themelorë një trashëgimi gjenetike të pandërmjetme ndaj kulturës materiale, shpirtërore e gjuhësore ilire.*

Pa dashur aspak të çbirilojmë, nëmos vërtet të fantazojmë, p.sh. se ç'do të ndodhte vallë, sikur të mund të arrinim të klononim dikur, madje edhe të mësonim

tufën e ADN-së së një iliri den-baba-den, ase të paktën atë të një luftëtari krutan të kohës së Skënderbeut e ta përqasnim atë me gjegjësen e ndonjë krutani gjynahqar në Sarı Saltık në kohë tonë, le të kthehemi më mirë me këmbë në tokën tonë albanologjike e të vëmë oroe, se kjo paraqitje pak a shumë sintezë e rrethanave dhe rezultateve që përjetojmë në këtë periudhë të dytë të albanologjisë historike shqiptare, na lejon tash, në rastin më të mirë, të vijojmë vëzhgimin tonë me një pyetje në dukje thjesht provokuese: Në ç'marrëdhënie qëndron vallë elita shkencore-intelektuale shqiptare e kësaj periudhe – e bashkë me të edhe Jubilari ynë – ndaj 'Çështjes Shqiptare' si pjesë e asaj pakete kontrolluese ideologjike me theks të fuqishëm nationalist, që formëzoi bazën mitologjike-historike të shtetit shqiptar, parë ky si një formacion shtetëror çfarëdo, veçse si i tillë ishte në gjendje të ushtronte dhunë të mirëfilltë strukturore, qoftë edhe informale, ndaj mendimit shkencor-intelektual shqiptar? Duke dashur të qartësohemi edhe më shumë në detaj, këtë pyetje lejohemi ta formulojmë disi ndryshe, pra në degëzime të saj, si p.sh.: a) Ishte vërtet aparati i propagandës shtetërore komuniste ai lugati dhe malukati që formëzoi, në mos e bastardoj këtë elitë, duke i mëkuar asaj atë paketë kontrolluese me theks të fuqishëm ideologjik-nacionalist?; apo b) ishin prurjet koherente-rezultative të kësaj elite bash në këtë periudhë (të dytë ?), të cilat iu imponuan qysh në fillim këtij aparati, i cili, duke i mirënjohur *de jure* si të mirëqena, erdhi e i ngjizi ato apet në paketën e vet kontrolluese, duke i përcjellë, falë dhunës së vet strukturore, në formën e tezave të gatshme e me vlerë aksiomatike qoftë në fushën e kërkimit të mirëfilltë albanologjik, ashtu edhe në fusha të tjera të kulturës dhe arsimit shkollor-universitar shqiptar?

Kësaj pyetjeje, sado naive apo native që mund të tingëllojë fillimisht, lejohemi t'i japim, nëse duam e tregohemi sadopak dashamirë (!!!), një përgjigje plot cem e sqimë, pra thjesht pragmatike, pra bindëse, në kuptimin që – sigurisht pa dashur assesi të shpojme kënd me bodecin e kritikës sonë qytetare e aq më pak Jubilarin tonë bash në këtë tubim – të lëvdojmë pa vënë cak e thanë si aktivitetin shkencor ashtu edhe angazhimin social të elitës intelektuale shqiptare në periudhën e dytë (?), bash në atë *komunisten* apo *hoxhisten* (Schmitt), që vjen me thënë atë të djallit kuq-e-zi, meqë:

- a) nga njëra anë albanologjia si shkencë komplekse rajonale u stimulua fuqishëm, si kurrherë më parë (!!!), pikërisht prej atij regjimi vërtet totalitar, ndër të tjera me ngritjen e një rrjeti të fuqishëm të infrastrukturës shkencore-universitare, e cila arriti vërtet një pikë kulmore në vitin 1972 me themelimin e Akademisë së Shkencave të (Republikës Socialiste të) Shqipërisë, në krye të së cilës u vu gjithashtu jo rastësisht Jubilari ynë;
- b) nga ana tjetër ishte bash ky regjim që kërkonte qoftë edhe si kompensim një farë shpërblimi prej kësaj elite, i cili, si i tillë, mund të mos kishte të bënte patjetër me rolin, prej saj sado të dëshiruar të puthadorit ndaj asaj politike vrastare të diktaturës së proletarietit, por të paktën një mirësjellje me nota të matura etike edhe konformizmi ndaj politikës së atij regjimi në shkencë, kulturë e arsim, çka vjen me thënë: qoftë duke i thënë e i dhënë atij 'burrërisht' fjalën e argjenditë, qoftë duke jesur e gjëllirë në suazën e tij, pra gjithherë (si dikur ?) në pakt me heshtjen e artë.

Raste të këtilla të ndërlikës në pakt e me mirëkuptim reciprok midis jetës shkencore-intelektuale dhe politikës vendore janë të njohura e të mirënjohura në historinë e lindjes dhe të zhvillimit të shkencave komplekse rajonale (kryesisht syresh të popujve të vegjël !) e për më tepër – në rastin konkret (!!!) – dëshmojnë mirëfilli lindjen dhe pagëzimin e albanologjisë si shkencë komplekse rajonale në Perëndim të Europës, ku sipas kohës dhe rastit kërkimi shkencor albanologjik erdhi e iu përshtat “me ose pa dashje” dhunës strukturore të të ashtuquajturit imperializëm/komunizëm informal, si p.sh.: dikur interesave hegjemoniste e aneksioniste të Derës së Habsburgut (sidomos prej gjysmës së shek. XIX e deri në vitet '20 të shek. XX) e më pas sosh të Sopotës së Liktorit (deri më 1944), sikurse më vonë syresh të diktatit komunist (deri më 1991).⁵

Për një pleksje të tillë interesash midis elitës shkencore-intelektuale në albanologji me politikën e dikurshme kolonialiste dhe hegjemoniste (të paktën deri në fund të Luftës së dytë Botërore) shkruesi i këtyre radhëve ka pasur madje rast të prononcohet dikur në një rrethanë të ngjashme, anipse të mëhershme, bash kur mori në analizë një letër-memorandum të enciklopedistit dhe filozofit të mirënjohur gjerman Gottfried Wilhelm Leibnitz drejtuar Leopoldit I të Habsburgut (Demiraj 2015 15vv.), e cila ishte pagëzuar jo më kot prej botuesit të saj kritik me nëntitullin: “Për pushtimin e Shqipërisë” (= lat. “De Albania occupanda” – shtator 1688)⁶ Në përfundimin tonë të dikurshëm, duke rrokur aty sigurisht edhe prurjet e albanologjisë austro-hungareze në bashkëlidhje me politikën hegjemoniste të Perandorisë së Dyfishtë (= të Habsburgut) në shek. XIX-XX, parapëlqyem gjithsesi të mbanim në dorë e në sy lupë e syze të bardha, prashtu duke i mëshuar si facit bash zgjidhjes alternative pragmatike të kohës, sipas së cilës, aktiviteti intelektual dhe angazhimi social i një personaliteti të shkencës do gjykuar në përputhje me kodin moral dhe etik të kërkimit shkencor për kohën, në të cilën dhe për të cilën ka vepruar e vepron.⁷

⁵ Për studime të detajuara sidomos për albanologjinë austro-hungareze shih së fundi Gostentschnigg 1999; 2006/7; 2012; (& Kaser) 2014.

⁶ Bëjmë fjalë këtu për një ndërhyrje sa mbushamendëse aq edhe të vetëdijshme të eruditit dhe enciklopedistit të madh pranë Derës së Habsburgut për të pushtuar Shqipërinë, pas gjase i nxitur thjesht dhe vetëm për përfitim personal (= pragmatik), meqë synonte prej kohësh të joshte vëmendjen e perandorit ndaj personit të tij e për rrjedhojë të bënte karrierë në oborrin e superfuqisë së asaj kohe, bash sipas motos: “Tek një i [plot]fuqishëm i madh gjenden mundësi ndër më të ndryshmet për ndërmarrje të dobishme.” “Bey einem grossen Potentaten sich weit andere Gelegenheiten zu nützlichen Verrichtungen finden.” (hollësisht Hirsch 2000 216vv.)

⁷ Citati i plotë: “Prekim në këtë rast një temë, e cila po fiton gjithnjë e më shumë terren në debatin shkencor albanologjik të kohës sonë, pikërisht atë ndërvarësi të supozuar në marrëdhëniet midis kërkimit shkencor albanologjik dhe politikës së një vendi që ka mbështetur apo mbështet me rrugë institucionale këtë kërkim. [...] Fokusin e këtij diskursi shkencor-historik e përjetojmë ndërkohë sidomos në disa analiza të studiuesve austriakë lidhur me marrëdhëniet ndërmjet albanologjisë austro-hungareze dhe një lloj planifikimi të mundshëm për ekspansion politik, ekonomik e kulturor të Derës së Habsburgut në Shqipëri në gjysmën e dytë të shek. XIX deri në fund të Luftës së Parë Botërore⁷, një periudhë kjo që u shoqërua me mbështetjen dhe mbarëvajtjen në vazhdimësi të kërkimit shkencor albanologjik në disa universitete si në Vjenë, Grac (= Graz), Budapest e Pragë, apo me

Asgjëmangut kjo lloj zgjidhjeje pragmatike ia vlen vërtet të përsiatet, nëmos të tumiret parimisht edhe në rastin tonë konkret, sa i përket sjelljes së elitës intelektuale shqiptare në Shqipërinë e Pasluftës, se edhe kjo elitë pjellë e kësaj bote njerëzore ishte, është dhe do të jetë. Në fund të fundit, ç'të keqe mbillte e pillte atëbotë kjo elitë e shkencës shqiptare, xhanëm (!?), në rast se produkti i vet e i mirëfilltë intelektual furnizonte (edhe) me ujë të bollshëm mullirin e imagjinatës dosido shterpëzuese 'komuniste' e bashkë me të edhe atë pak krenari 'nacional(ist)e' që na kishte mbetur, duke i mbajtur kështu anën një bashkëlidhjeje etnike-gjuhësore të drejtpërdrejtë me kulturën ilire të antikitetit, bash me bartësit e saj, ilirët tanë po aq antikë? Po të flitej atëbotë, sikurse flitet sot në demokraci, me të ashtuquajturën 'gjuhë e fakteve' aq të (mirë)njuhura në kronikat e antikitetit, këta ilirët tanë – mor babam?! – m'i kujton e m'i harron, kur dhe si m'i do; varet kjo thjesht dhe vetëm se çfarë lupe mban në dorë, çfarë syzesh në sy e jo rrallë e për mall, nëse se je ngritur ose jo me mahmur nga gjumi i një nate më parë. E kjo rrethanë feks sidomos, kur mbikëqyr atë fisin tonë ilir më të thekur, bash ata: *illyrii proprie dicti*, të cilët nuk lenë rast pa i treguar me gisht, se ishin – or, mik?! – një racë sarhoshësh den-baba-den që pinin vençe, pa majë e cak, *sabaian* tipike ilire, sidomos kur digjej 'pa hile' prej grurit të popujve fqinjë, madje sidomos – e kjo aspak e dorës së dytë a të tretë (!!!) – kur ishin kthyer në dhe të vet, pasi u kishin rënë kryq-e-tërthor me lundrat e veta po aq tipike ilire ujërave të Adriatikut e Jonit, sigurisht si piratë e plaçkitës më se të zakonshëm që të vrisnin natën e s'të qanin as ditën, bash siç ia punoi vetë të vëllait mbreti i fundit ilir, Genci.

themelimin Komisionit Ballkanik në Vjenë (Balkan-Kommission – 1897) dhe të Institutit Ballkanik në Sarajevë (Balkan-Institut – 1908). Bëhet fjalë gjithashtu për një periudhë, kur sidomos Shqipëria e Veriut me bashkësinë katolike shqiptare u ngërthye në suazën e të ashtuquajturit Protektorat Kulturor të Monarkisë së Dyfishtë; një periudhë pra, kur u formëzua në kuptimin e mirëfilltë të fjalës albanologjia (austro-hungareze) si shkencë komplekse në thuajse të gjitha disiplinat e saj (: gjuhësi, histori, gjeografi, e drejtë zakonore, kulturë popullore, arkeologji etj.), e për më tepër një periudhë, kur studiuesit e mirëfilltë, përpos kërkimit shkencor mund dhe duhet t'i kenë shërbyer në një mënyrë a një tjetër edhe interesit politik, ushtarak, ekonomik dhe kulturor të të ashtuquajturit 'imperializëm (in)formal' në kuadrin e posëashtuquajturës 'dhunë strukturore' që mund a duhet të ketë ushtruar sistemi shtetëror, në të cilin dhe për të cilin shërbenin. Bëhet fjalë pra për një strategji politike-ushtarake dhe ekonomike apo një ndikim të programuar kulturor afatgjatë të Austro-Hungarisë në trevat shqiptare, të cilët u shoqëruan më pas me pushtimin e pjesës më të madhe të trevave shqiptare prej Austro-Hungarisë gjatë Luftës së Parë Botërore (1916 - 1918).

Në fokusin e kësaj perspektive studimi janë përfshirë ndërkohë prurjet e studiuesve të mirënjohur në albanologji si: Johann G. v. Hahn (konsull në Janinë), Theodor A. Ippen (konsull në Shkodër), Milan Šufflay, Josef Konstandin Jireček, Ludwig v. Thallóczy, Franz Baron Nopcsa, Maximilian Lamberz, Gjergj Pekmezi, R. Nahtigal, Franz Seiner etj. Sa kanë qenë këta studiues të vetëdijshëm për këtë ndërlikë të shkencës me politikën, përkatësisht në ç'masë i ka shërbyer njëri apo tjetri me ose pa vetëdije kësaj politike, janë këto çështje që i kapërcejnë caqet e debatit të mirëfilltë albanologjik, sa kohë që angazhimi social dhe aktiviteti intelektual i njërit apo tjetrit studiues ruan parametrat e kodit moral dhe etik të kërkimit shkencor për kohën, në të cilën dhe për të cilën kanë vepruar. Parë nga kjo perspektivë edhe kjo aktiviteti shkencor-intelektual dhe angazhimi social-politik i Leibniz-it për Shqipërinë, shqiptarët dhe gjuhën e tyre fiton edhe me shumë kuptim, edhe pse memorandumun e tij e përcjellim sot me titullin e pagëzuar për herë të dytë 'De Albania occupanda'" (Demiraj 2015 23v.)

Parë nga kjo perspektivë e duke mbajtur vazhdimisht vath në vesh temën qendrore të këtij tubimi, shumëkush vetëm do të tumirë fjalë pas fjale e rresht pas rreshti një gjykim të mprehtë ndaj atij pozicioni bifunksional të Jubilarit tonë, ashtu siç e ngjërojmë në studimin monografik “Historia dhe Albanologjia” (Tiranë 2007) me autor Dritan Egron, të cilin ia vlen vërtet ta riprodhojmë këtu të plotë, si vijon:

“Studiuesit e sotëm të diplomuar jashtë Shqipërisë e kanë mundësinë me pash që të shprehen lirisht, madje të fusin në shkencën historike shqiptare atë çka është e re dhe moderne. Kurse të diplomuarit jashtë vendit në kohën e Zogut, dhe që periudha e pjekurisë profesionale dhe prodhimtarisë shkencore u përkoi me sundimin komunist, nuk e patën këtë mundësi. Po t’i lexosh me vëmendje shkrimet shkencore të A. Budës do të vësh dualitet mendimi dhe shkrimi, por gjithmonë një gjë e tillë është shprehur me shumë elegancë për të qenë brenda kornizave të ashpra të vendosura nga regjimi komunist. Ky fakt na bën që të mos anashkalojmë edhe faktin që A. Buda ishte një ndër përfaqësuesit e paktë të studiuesve shqiptarë që periudha komuniste i trashëgoi nga periudha e mëparshme. Falë formimit që gëzonte ai përfaqësonte profilin e profesionistit të padiskutueshëm në kushtet e Shqipërisë. Tek shkrimet e A. Budës, ndonëse të pakta për atë fuqi krijuese që ai posedonte, studiuesi nuk ka se si të mos vërejë se shkrimi i tij më shumë se një produkt i punës mekanike është produkt analitik i fuqisë sintetizuese, falë një formimi të shëndoshë të marrë në shkollat jashtë vendit. Me autoritetin shkencor dhe pushtetin politik që gëzonte vetëm ai mund të shprehte, qoftë edhe me shumë elegancë, mendime që për historianët e tjerë ishin të ndaluara. Formimi solid historik dhe përdorimi mjaft i mirë i shqipes, bashkuar edhe me autoritetin e tij intelektual, ishin më se të mjaftueshme që në disa raste ai të shkruante në mënyrë të dyzuar. Gjithsesi, ky shkrim i dyzuar, por që kurrë nuk shprehu hapur atë çka ai mendonte, bëri që Buda asnjëherë të mos merrte përsipër rolin e disidentit, por po aq edhe të mos klasifikohet tërësisht si konformist.” (Egro 2007 102)

Se në ç’masë e thellësi ky vlerësim mund a duhet t’u përshtatet edhe atyre prurjeve shumë më të bollshme të elitës intelektuale shqiptare që përmendëm – madje edhe me emra (!) – më lart, këtë le t’ia lemë më mirë ta gjykojë vetë syri, dora dhe penda e lexuesit sqimatar të këtij vëllimi përmbledhës të tubimit, sado i rrudhur në numër që ka përfunduar (si mos o Zot!!!) ky lexues bash në kohën tonë, kur të mbysin e të zhysin vetëm botimet e autorëve të përkorë sa s’kanë arritur ende të marrin titullin kobndjellës “të profesorit” e sidomos atë “të akademikut shqiptar”. Për kumtin tonë ka fillimisht më shumë rëndësi fakti që ishte pikërisht ajo aradhe studiuesish intelektualë shqiptarë (sidomos në fazën e parë të kësaj periudhe të dytë) që hyn vetëdijshëm dorëzanë dhe tumir, pas gjase, në unison njëjërën zgjidhje alternative të ‘Çështjes Shqiptare’, e cila, siç do ta rimarrim më poshtë, nuk cenonte aspak normën morale e qytetare, sikurse edhe atë etike të diskursit shkencor albanologjik bash në kohën dhe për kohën, në të cilën këta studiues ushtruan aktivitetin e tyre intelektual me angazhimin social përkatës; qoftë edhe thjesht për të

fituar bukën e gojës e për të mbajtur shpirtin gjallë: të vetin dhe atë të familjes që kishin në ngarkim.

Pas këtij ekskursi mbi ndërlikjen e patëkeqe në kohë dhe hapësirë të aktivitetit shkencor-intelektual me kursin politik-ideologjik që përkujdes një formacion shtetëror (i çdo lloj ngjyre a luleje qoftë) bëhemi tash më se të ndërgjegjshëm edhe për atë dozë pragmatizmi që mund a duhet të ketë shoqëruar potencialisht të paktën një pjesë të elitës intelektuale shqiptare, e pse jo edhe vetë diskursin e mirëfilltë historik albanologjik në periudhën e regjimit totalitar-unitarist në Shqipërinë e pas-Luftës së Dytë Botërore, derisa ky regjim u zbyth një herë e përgjithmonë prej arenës politike kombëtare e ndërkombëtare.

Asgjëmangut, ky pragmatizëm, sado i sëmurë – por të paktën i mirëkuptueshëm, në mos edhe më se i arsyeshëm –, që mund të duket e të tingëllojë në pamje të parë, nuk i shkon aspak përshtat ndonjë gjakoi çamarrok me post historiani në detyrë, qoftë ky edhe i huaj, por që s’ka fare haber, pra s’ka jetuar, përjetuar, ndjerë e përndjerë dikur a diku në mish e në shpirt, madje den-baba-den as në fis e në familje, fate njerëzish të pafat, pra edhe sosh historianësh dhe albanologësh shqiptarë që nuk i lanë ‘pendlat e korbit’ vendit të vet, por jesën dhe jetuan jetën e vet nën diktaturë, madje nën atë më të zezën, më mizoren në Europën e gjysmës së dytë të shek. XX: bash nën diktaturën komuniste shqiptare të viteve 1945-1991.

Prashtu nuk kemi përse bëjmë tash aspak çudi, që të jetë pikërisht njëri ndër këta gjakoj ndërkombëtarë që i jep sot e gjithë ditën të drejtën vetes të edukojë dhe mbarështojë albanologjinë historike shqiptare, duke (zh)vlerësuar *en bloc* të gjithë ata pinjollë të elitës së dikurshme intelektuale shqiptare, përkatësisht të damkosë e linçojë në masë e në varg si lebrose çdo lloj prurjeje të saj në shkencat historike albanologjike përgjatë kësaj periudhe. E njëri ndër këta nihilistë të vonuar në historinë e albanologjisë është jo rastësisht Oliver Jens Schmitt (Uni. Vjenë; me studime të rregullta në LMU Muni/RFGJ; i lindur dhe i rritur në Zvicër, si gjithherë vend neutral e pa kurrfarë përvoje të jetës nën diktaturë). Ky historian pas gjase i ka vënë vetes një qëllim sublim në jetë: të nxjerrë faret, pra pa nam e nishan (!), gjithçka që mban rubë a tingëllon shqiptare në studimet historike albanologjike edhe përgjatë gjithë kësaj periudhe (sipas tij gjithsesi: të parë). E këtë e bën, ashtu siç (mirë)pritet, në emër të lirisë së amshuar, pra me duar e dorashka të pastra të Shkencës në përgjithësi ase të Shkencëtarit në veçanti prej asaj dhune strukturore që ushtron a pritët potencialisht të ushtrojë aparati i një formacioni shtetëror dosido: Ah, moj Liri; azretja Liri!? Sa herë që të zënë me gojë, me sy e me dru ty këta tipa të sertë, më nxjerr mua të varfrit gjithherë mallin e Xhaxhit, kur e mësonim dikur përmendësh dhe na gufonte zemra e kraharori sipas kohës e rastit: në bankat e shkollës fillore, tetëvjeçare, të mesme, universitare e pasuniversitare, se: “Edhe bar hamë ne shqiptarët, por parimet e Marksizëm-Leninizmit nuk i shesim!”

Sigurisht që nuk do t’ia vlente vërtet barra qiranë me përsëritur vetveten edhe në këtë shkrim, duke u marrë rishtas me këtë studiues, përkatësisht me ato dënime gjithherë kapitale që ky rob Zoti i gatuar së prapthi – të cilit sistemi komunist për

arsye vendi e moti vështirë t'i jetë shfaqur dikur as në ëndërr (!) – i mballos çdo rast elitës intelektuale shqiptare në Shqipërinë komuniste.⁸ Gjithsesi shprehim bindjen se nuk bëjmë aspak gabim, nëse e ripërmendim këtë emër sado shkurt, sepse është bash ky historian, si i vetmi studiues jo-shqiptar, që i ka kushtuar dikur Jubilarit tonë një studim më vete, i cili mban jo-rastësisht titullin: “Shoku Aleks dhe Partia e tij, ose: Mbi politikën dhe shkencën e historisë në Shqipërinë komuniste (1945-1990)” (= “Der Genosse Aleks und seine Partei oder: Zu Politik und Geschichtswissenschaft im kommunistischen Albanien (1945-1991)” – 2005 143vv.) Kush e ka pasur, ka a do ta ketë atë ‘fat’ me e lexuar dikur këtë shkrim, nuk e ka (pasur) ase do ta ketë të vështirë me ardhur po vetë në përfundimin se atë shkrim të tij e nis, e stolis dhe e bitis fund-e-krye një syzim ogurzi: duke marrë si etalon angazhimin social të Aleks Budës si ish-kryetar i Akademisë së Shkencave të (Republikës Popullore të) Shqipërisë, Schmitt-i ynë rreket të deklasojë të gjithë aktivitetin shkencor-intelektual së bashku me angazhimin social të tij sikurse të gjithë asaj elite intelektuale shqiptare, e cila pati atë fat – që i ra si i tillë (!!!) – jo vetëm të jetonte e mbijetonte dekada të tëra nën diktaturë, por, sipas tij, edhe të puthadorte pa kushte, përkatësisht të vihej vetëdijshëm e me dëshirë sublime në shërbim të së ashtuquajturës *Shkencë Hoxhashqiptare* (: ‘Hoxhaalbanische Wissenschaft’).

Asgjëmangut, siç theksuam më lart, nuk duam të përsërisim aspak vetveten në këtë shkrim, duke u marrë (rishtas) me meskinitetin pas gjase të pashërueshëm të këtij studiuesi edhe sa i përket portretizimit – në jo pak raste të pasaktë, d.m.th. të deformuar⁹ – që merr guximin t'i bëjë Jubilarit tonë. Prashtu lejohemi t'i anashkalojmë vetëdijshëm çdo lloj ndërhyrjeje kritike që vërtet s'të jep më (pra sot) as bukë, as ujë e as kripë, meqë shkruesi i këtyre radhëve e ka ngjizur me kohë dhe ndërkohë në mendje dhe shpirt bindjen se ky gjykatës ndërkombëtar e pa kurrfarë përvoje e haberi me jetën shqiptare nën komunizëm, nuk e di as vetë se ku ia çon mushka drutë, kur merret bash me prurjet e albanologjisë shqiptare në kohë e hapësirë, andaj e kemi më të lehtë me vazhduar në hullinë e zakonshme të punimit tonë modest, duke marrë si pikë referimi vetëm një copë citati që na shfaqet në atë shkrim të tij, si p.sh.:

„Shkenca hoxhashqiptare caktoi si tema të rëndësishme ilirët në antikitet, të cilët u vështruan si pararendës të pandërmjetshëm të shqiptarëve të sotëm. Shkenca, [e vënë – B.D.] në shërbim të interesave shtetërore-politike duhej të vërtetonte katërcipërisht me dëshmi këtë aksiomë. [...]”¹⁰

⁸ Shih B. Demiraj 2012 35v.; 2014 39vv.

⁹ Kështu p.sh. Schmitt (2005 148, 149vv.) pranon vetë se për të përshkruar karakterin e Budës u referohet kryesisht fjalëve të tija hapjen e tubimeve, ku kërkohen gjithsesi doza të fuqishme retorizmi, kryesisht në tubime shkencore (të një rëndësie të veçantë) politike. E pafalshme është megjithatë mënyra e denigrimit të personit në fjalë jo duke cituar kumtet e veta, se sa duke iu referuar me nota të theksuara sarkazme fjalëve të botuesit (Stefanaq Pollo) në hyrje të vëllimit me përmbledhje shkrimesh historike të Aleks Budës (“Shkrime historike, bl. 1-2, Tiranë 1986, f. 4).

¹⁰ Paragrafi origjinal: “Als wichtige Themen stellte die hoxhaalbanische Wissenschaft die Illyrer im Altertum, die als unmittelbare Vorfahren der heutigen Albaner angesehen wurden, in den

Është pikërisht ky citat që për mendimin tonë, krejt të patëkeq sendërton njëri ndër zgjidhjet alternative, pra potenciale, të asaj pyetjeje, më saktë bash të derivatit të saj të parë, që formuluam pa teklif më lart, shi nëse ishte vërtet aparati i propagandës shtetërore komuniste ai lugati dhe malukati që formëzoi, në mos e bastardoj këtë elitë, duke i servirur asaj atë paketë kontrolluese me theks të fuqishëm ideologjik-nacionalist (?); apo ishin prurjet koherente-rezultative të kësaj elite, të paktën në fazën e parë të kësaj periudhe të dytë, të cilat erdhën e iu imponuan qysh në fillim këtij aparati, i cili, duke i mirënjohur fillimisht si të mirëqena, erdhi e i ngjizi në paketën e vet kontrolluese, duke i përcjellë më pas falë dhunës strukturore në formën e tezave të gatshme e me vlerë aksiomatike qoftë në fushën e kërkimit të mirëfilltë albanologjik, ashtu edhe në fusha të tjera të kulturës dhe arsimit shkollor-universitar shqiptar?

Asgjëmangut, për një përgjigje bindëse, pra fare të thjeshtë, që i detyrohem lexuesit, lejohemi të vëmë oroe, se diktatori i madh – sikurse kushdo në aparatën e tij të propagandës ideologjike-nacionaliste –, nuk ka qenë kurrherë në gjendje të bënte dikur deduktime kësodore lidhur me ‘Çështjen Shqiptare’. E kjo për një arsye thjeshtë, në mos fare banale: ai vetë, sikurse shumëkush në atë aparat, edhe në rast se kishin të përfunduar me letra ndonjë gjimnaz, shkollë profesionale, në mos edhe të lartë, sigurisht që nuk e kishin gëzuar kurrë atë formim qoftë edhe të brishtë, sa të mund të pjesëmerrnin sado skajshëm e pa kompleks inferioriteti në një debat intelektual të natyrës së mirëfilltë shkencore-albanologjike. Dhe përjashtim nga e gjithë kjo mesele nuk bënte padyshim as diktatori i madh, i cili një ditë të bukur ditësh, kujtohet të pyesë zëllart e kryeneças: “Po pellazgët?”¹¹ Shumëkush prej elitës intelektuale shqiptare të kohës, pra gjithkush që kishte a i kishin mbetur (ende) ndopak mend në kokë, i kërkoi, i gjeti dhe i përshkoi si mudi e ku mudi, por gjithnjë me lezet – pra në mënyrë pragmatike (!!!) – rrugët e mundësitë të dilte po vetë prej atij qorrrokaku plot bërlllog mendor e që kundërmonte vetëm injorancë intelektuale. E në këtë rast nuk lejohemi të ‘shpallim të pafajshëm’ assesit patjetër vetëm Jubilarin tonë, apo akoma më çlirshëm Çabejn e Madh, si ajka e albanologjisë shqiptare dhe të huaj, më se i njohur e i mirënjohur çdo kohë e mot si modeli i elitës intelektuale shqiptare nën ‘diktaturën hoxhiste’, i cili nuk diti, sepse nuk donte as të dinte, t’i përulej politikës dhe ideologjisë së çfarëdo ngjyre qoftë. E përse të mos shtiem mes tonë – mor jahu!!! – edhe elbasanliun ‘qetër’, fjalëpakun e punëshumin, Mahir Domin dora vetë, më se i mësuar ‘aso gjanash’, madje mësoi i ziu – ndryshe nga ilirët (!!!) – edhe si të qante vetëm natën të atin e zhdukur në burgjet komuniste, apo vlonjatin Shaban Demiraj, të cilit, edhe pse ish-partizan e me dy vëllezër të zhdukur në kampet shfarosëse naziste, i mbanin sipas kohës e rastit, por gjithherë vath në vesh shkollën e kuranit dhe medresenë në Tiranë, aq sa e mbylli i ziu jetën shurdh.

Mittelpunkt ihres Interesses. Die Wissenschaft hatte hier im Dienste staatspolitischer Interessen dieses Axiom des alb. Selbstverständnisses nachträglich mit Belegen zu untermauern. [...]“ (Schmitt 2005 145)

¹¹ Shih më lart shën. 3.

Që kjo elitë intelektuale shqiptare e kohës, sado e rrudhur atëbotë në numër – sidomos prej represionit, linçimit dhe shfarosjes çnjerëzore e në masë që ndërmori regjimi vrastar komunist (!!!) – i përcolli debatit albanologjik një zgjidhje alternative ndaj ‘Çështjes Shqiptare’ sa bindëse për kohën, aq edhe të patëkeqe për atë kohë: bash tezën ilire të vazhdimësisë kulturore etnike-gjuhësore të popullit shqiptar, për këtë realitet shkencor-albanologjik shqiptar nuk ka nevojë aspak të tjerim e thurim kritikë qytetare ndaj përsiatjeve perverse të këtij historiani zullumqar, i cili, thënë troç:

- a) vuan nga një alergji vetiake e pashërueshme, pra e pandreqshme ndaj vetë Lëvizjes patriotike-ideologjike të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, e cila bëri dikur Shqipërinë (29 nëntor 1912) e, për rrjedhojë, në kohën tonë edhe Kosovën (17 shkurt 2008); sikurse edhe ndaj nderimit dhe respektit që ka, përkatësisht ka fituar në rrjedhë të kohës, një komb i vogël ndaj heroit të vet sa historik: Gjergj Kastriotit, aq edhe legjendar: Skënderbeut dora vetë (Schmitt 2009);
- b) s’ka kurrfarë haberi mbi realitetin e vërtetë shkencor-intelektual e social-kulturor në Shqipëri nën diktaturën komuniste; e akoma më zi: nuk e ka vënë ende dorën në zjarr që të dijë e të mësojë më shumë, se ka pasur dikur e ka ende sot një debat të pastër e të panjollë albanologjik edhe ndër rrethe intelektuale-shkencore shqiptare (Schmitt 2005; 2012), të cilat kanë ardhur, parë e fituar sa herë që kanë mundur e kur e ku kanë mundur një bashkëpunim të sinqertë e konstruktiv në rrethet kolegjiale përkatëse në Europë e gjetkë.

Asgjëmangut, bash në këtë pikë të fundit e ka pasur atëbotë dhe e ka edhe tani ‘Tahiri llafin!': vijnë pra natyrshëm e rrjedhshëm në atë përfundim që e kemi hedhur dikur çiltas e patëkeq në letër të bardhë, pikërisht kur jemi marrë konkretisht me ndryshimin e paradigmës në kërkimin shkencor diakronik të ‘Çështjes shqiptare’, pra edhe në diskursin intelektual-shkencor shqiptar, bash në periudhën kur (edhe) në Shqipërinë e Pasluftës u nxit dhe u përftua – e përse duhet ta fshehim, xhanëm!? – një rrjet infrastrukturor solid i studimit shkencor albanologjik. Brenda hapësirës që na lejon bordi redaksional i këtij vëllimi, lejohemi t’i përcjellim tash lexuesit pikërisht atë përshkrim të mëhershëm të ndryshimit të paradigmës metodologjike të hulumtimit të ‘Çështjes Shqiptare’ në historinë e mendimit shkencor albanologjik shqiptar, përkatësisht të kalimit nga *periudha jokritike* në atë *kritike*, të cilin e kemi përsiatur dikur, si vijon:

“Të nxitur nga kjo qasje retrospektive e ‘çështjes shqiptare’ në zanafillën e saj, siç e njohim sot për sot, nuk besojmë se gabojmë, nëse debatin intelektual shqiptar-arbëresh e këndvështrojmë tash në kah perspektiv përgjatë shekujve në vijim, e për rrjedhojë të mëtojmë pa hezituat aspak që ai u mbështet fuqishëm bash në këtë traditë interpretimi të ‘çështjes shqiptare’, sigurisht duke përfituar në të njëjtën kohë edhe prej mendimit intelektual-albanologjik që kishte zënë të hidhte rrënjë e shtat në Europë qysh në fillimet e shek. XVIII¹².

¹² Dallojmë këtu sidomos letërkëmbimin e enciklopedistit dhe filozofit gjerman Gottfried Wilhelm LEIBNIZ (shih hollësisht DEMIRAJ 2001 163vv.; 2005b 13vv) si edhe veprën e studiuesit suedez THUNMANN (1774 254v.).

Janë këto rrethana, që i shtojnë debatit mbi prejardhjen e etnosit shqiptar elemente të reja, si gjithëherë në varësi me konstantet 'kohë' dhe 'hapësirë'. Prashtu, vërejmë që etnosi shqiptar syzohet si i tillë gjithnjë e më shumë si përzjerje etnish të mëhershme të Ballkanit antik, ndër to ato epirote-maqedonase me elemente shtesë kryesisht greke e romake të periudhave helene, romake e bizantine (GUZZETTA, CHETTA¹³), duke iu shtuar sipas rastit edhe elemente ilire (MASCI 1807¹⁴), gjithsesi vetëm syresh të *ilirëve të lashtë*¹⁵, ndërkohë që tharmit anas, pra atij zanafillës të etnosit, i ngjizur ky sidomos në gjuhën shqipe, erdhi e iu pagëzua – pasi u gjurmua dhe u pikas shumë më thellë në kohë – bash ëma e ëmave, fatlumja e gjithë kulturave dhe gjuhëve (vetëm ?) të Europës. Bëjmë fjalë këtu pikërisht për kulturën pellazge dhe kumtin e saj, pellazgjishten, aq të përgojuar e po aq të himnizuar sot në debatin intelektual dhe në diskursin publik shqiptar. Një pikë kulmore të mendimit intelektual shqiptar-arbëresh të kohës do ta përjetojmë pikërisht në fund të shek. XIX në vargjet e Poetit tonë:

<p><i>Bota që kur është zënë, Shqipëria gjall ka qënë. Pellazgj' u thoshin më parë, Në së fundi Shqipëtarë. Gjuh' që flisjin Perënditë Atë flisjin Pellazgjitë; Atë kanë Shqipëtarët, Si q' e kishin dhe të parët. Gërqishten ajo e polli, Llatinishtja andej doli</i></p>	<p><i>Bijtë tanë jan' Elinët Sindëkur edhe Llatinët, Edhe gjithë Evropianët Që duallë nga Romanët. Nëve jemi më të parë, Në Evropë nga çdo farë. Gjithë bota vij qëmoli, Në Tomor tek ishte Zoti, I falëshin Perëndisë, Zotit math të Shqipërisë.</i></p>
--	---

(Naim FRASHËRI: Shqipëria 1897)

Duke lexuar këto vargje e përcjellë ato tash si tufëz të argumentit historik vs. mitik në programin ideologjik të Lëvizjes së Rilindjes Kombëtare Shqiptare, nuk bëjmë gjë tjetër, veçse përcjellim thukët në rrjedhën e tij mendimin intelektual-albanologjik shqiptar, të formëzuar në shekuj e që arriti këtë pikë kulmore bash në kuadrin e asaj lëvizjeje që bëri dikur Shqipërinë, e për rrjedhojë në kohën tonë edhe Kosovën. Pa dyshim që nuk gabojmë aspak, në rast se mëtojmë që ky mendim erdhi e mori formë në bashkëvajtje me mendimin albanologjik në rrethe të ndryshme shkencore-

¹³ Shih më hollësisht DEMIRAJ 2007a 63vv.; 2007b 9vv.

¹⁴ Shih më hollësisht DEMIRAJ 2002b 115vv.

¹⁵ Emërtim i bërë nga Gottfried Wilhelm LEIBNIZ për t'i dalluar nga *ilirët modernë*, me të cilët identifikoheshen atëkohë popullsitë sllave përgjatë bregdetit dalmat, kryesisht kroatët. Shih më hollësisht DEMIRAJ 2001 168vv.

intelektuale në Europë¹⁶, duke iu përshtatur gjithherë zhvillimit të metodave të reja të hulumtimit diakronik. Dhe ishte bash përditësimi me arritjet e një numri jo dosido albanologësh të huaj¹⁷, çka mundësoi debatin albanologjik shqiptar në gjysmën e parë të shek. XX të përfaqonte njëherazi edhe një paradigme të re në hulumtimin shkencor-diakronik: metodën historike-krahasimtare.

Ballafaqimi i metodave të ndryshme të studimit, përkatësisht i rezultateve të arritura prej zbatimit të tyre, përcolli kështu në periudhën midis dy luftërave një klimë të re në debatin intelektual shqiptar, sidomos lidhur me çështje të 'etnogjenezës shqiptare'. Pikërisht në këtë klimë, që ishte shtrirë edhe gjetkë në Europë, hiqet dorë një herë e mirë prej amësisë imagjinare pellazge për t'i bërë vend sa e siç duhet asaj atëbotë më tokësore, shi tezës ilire të prejardhjes së popullit shqiptar, të kulturës dhe gjuhës së tij, parë kjo si bartëse e atij tharmi sa material aq edhe shpirtëror të vetë etnosit shqiptar në mijëvjeçarët e historisë dhe parahistorisë së tij ballkanike. Pa dashur të mënjanojmë aspak pararendës dhe/ose bashkëkohës të tij në historinë e albanologjisë shqiptare (p.sh. Angelo MASCI 1807, Ndre MJEDA 1935 etj.) e sidomos të asaj në Europë, lejohe mi të përmendim me këtë rast vetëm emrin e albanologut të shquar shqiptar Eqrem ÇABEJ si zëdhënësi e dorëzanësi kryesor i kësaj teze, i cili me veprën e vet madhore dhe autoritetin e padiskutueshëm edhe në rrafsh ndërkombëtar bëri të liheshin dashur-pa dashur në hije, madje të tërhiqeshin një herë e përgjithmonë prej debatit intelektual shqiptar teza e mendime të tjera të mëhershme ose bashkëkohore¹⁸."

Me riprodhimin e këtij pasazhi të gjatë, të shkëputur prej një studimi të mëparshëm shpresojmë t'i kemi dhënë përgjigje pozitive dhe bindëse asaj pyetjeje derivate të skicuar më lart, se ishin pikërisht prurjet koherente-rezultative të kësaj elite bash në këtë periudhë (të dytë ?), të cilat iu imponuan qysh në fillim aparatit të propagandës ideologjike-nacionaliste në Shqipërinë komuniste të Pasluftës. Për më tepër nuk gabojmë aspak, në rast se vëmë pikat mbi <i>, apo më saktë pikat mbi <ë>, e vërejmë që kjo elitë nuk veproi assesi në izolacion të plotë, përkundrazi gjithherë nën ndikimin e fuqishëm të kulturës shkencore dhe të traditës albanologjike

¹⁶ Ndër albanologët e parë që përkrahën këtë teori citohet vazhdimisht Johann Georg von HAHN (AS I 1854 245vv.), i cili në fakt vë shenjën e barazisë midis ilirëve dhe pellazgëve (= si term gjithëpërfshirës).

¹⁷ Ndër albanologë të huaj që dallohen në këtë periudhë (gjysma e dytë e shek. XIX – fillimi i shek. XX) e që përkujdesin lidhje intensive me studiues dhe rilindas shqiptarë dallojmë ndër të tjerë: Gustav MEYER, Holger PEDERSEN, Norbert JOKL, Ludwig von THALLÓCZY, Franz Baron von NOPCSA etj. Për historikun e zhvillimit të këtyre tezave shih së fundi Sh. DEMIRAJ 1999 69vv.; 2013 199vv.

¹⁸ I tillë është p.sh. botimi i Spiro KONDËS: Shqiptarët dhe problemi pellazgjik, Tiranë 1962; ndërkohë që Mahir DOMI (1982) ishte ende në kërkim të elementeve trake në gjuhën shqipe. Në këto vëzhgime hyrëse kemi hequr dorë me vetëdije prej teorish e tezash të tjera mbi marrëdhëniet e filiacionit të shqiptarëve dhe gjuhës shqipe, të cilat s'kanë kurrfarë lidhje me objektin e triptikut në vazhdim, e për rrjedhojë do të sillnin vetëm çoroditje te lexuesi i këtij punimi.

perëndimore europiane, ku kjo elitë jo vetëm u formua si e tillë, por që – edhe në kushtet e izolacionit ekstremist të majtë – rrrëmonte e gjente ku të mundte e si të mundte ato mundësi reale, d.m.th. sado minimale, për të ndërkëmbyer mendime, teza e ide në diskursin shkencor të kohës në Europën Perëndimore (khs. Ölberg 1972). E në këtë pikë nuk guxojmë të shohim si përjashtim e aq më pak me syze të zeza vetëm Jubilarin tonë si gjoja anëtar i besueshëm i “Partisë së tij”.

Sigurisht përgjigja ndaj kësaj pyetjeje të parë, sindëkur edhe derivateve, më saktë, riformulimeve të saj, nuk i vë aspak kufirin të thana një të dyte, që mund a duhet të tingëllojë, si vijon: Në ç’masë erdhi e ndikoi ‘teza ilire’ e prejardhjes së popullit shqiptar si pjesë e asaj pakete kontrolluese të shtetit komunist me aparatit e tij të dhunës ideologjike-nacionaliste në formimin kulturor-universitar në vend, si edhe në prodhimin shkencor të brezat e rinj të studiuesve shqiptarë që formoheshin, përkatësisht ishin të detyruar me u formuar në shumësinë e vet në izolacion të plotë, pra vetëm në ato institucione universitare e shkencore që jeshin në Shqipërinë e diktaturës së proletarietit?

Kjo pyetje e dytë bëhet më se domethënëse, sidomos në qoftë se duam të hedhim sadopak dritë qoftë edhe në disa ndër arsytet e atij ngërçi shumëplanësh që përjeton ndërkohë debati shkencor-albanologjik shqiptar, bash në të ashtuquajturën periudhë e tretë, të cilën jemi mësuar ta ngjerojmë (në këta plot 25 vjet) sidomos si *postkomuniste*, në mos: për mëshirë të Zotit (!!!) edhe *demokratike*, anipse bën mirë të emërtohet metëkeq – e pse jo (!) – si *periudhë e tranzicionit intelektual shqiptar*, sepse bashkëmbart, më saktë tërheq zvarrë vetëm tipare negative, nonse e zhveshur prej çdo lloj dhune strukturore të pushtetit shtetëror aktual. Përndryshe, nuk kemi përse bëjmë më aspak çudi, që sot në kohën tonë, bash në këtë periudhë të tretë, guxojnë të kapin e ngrenë kokë- e duarlart, ase edhe më keq: të fusin (vjedhurazi) në xhep skeptrin e elitës intelektuale shqiptare një numër aspak i vogël pinjollësh bastardë të atyre brezave që u formuan bash në këto institucione, sidomos në fazën e mbrame të kësaj periudhe të dytë.¹⁹ Veçse një hetim e përshkrim i tillë do t’i kalonte caqet e një studimi që ia kushtojmë Jubilarit tonë në këtë tubim.

Si përfundim shprehim bindjen, se shtjellimi i hollësishëm i kësaj pyetjeje (aspek të dorës) së dytë²⁰ jo vetëm na detyron të ngulim thellë e më thellë gishtin tregues në atë plagë qelbi e gangrene gjysmëshekullore që përgatiti e përkujdesi me zellin dhe perversitetin e të mësezakonshëm sistemi politik-shoqëror komunist me aparatit e vet të dhunës strukturore në Shqipërinë e Pasluftës, duke orientuar njëanshëm formimin intelektual shqiptar, thjesht e vetëm me syzimin sa largvajtës, aq edhe ogurzi, me krijuar intelektualin e ri shqiptar me një injorancë të thellë e të pashembullt kulturore-historike e si bartës i një ideali të ri po aq injorues, sa të

¹⁹ Këta i gjen me turra e me tufa në ribotimin e “Fjalor Enciklopedik Shqiptar” (I-II, Tiranë 2008-9) me redaktor përgjegjës jo rastësor, që nuk mungon t’i bëjë vend vetes në të me një zë të tipit të mesëm (FESH 2008-9², f. 1448 v.: <Emil Lafa> – 40 rreshta).

²⁰ Kësaj çështjeje i kemi kushtuar një studim të veçantë në dy numra të suplementit “Milosao” (2016: nr. 239, 240), duke përfshirë në të edhe shfaqet dhe arsytet e stagnacionit që përjeton ndërkohë shkenca albanologjike shqiptare gjatë kësaj periudhe të stërzgjatur të tranzicionit shoqëror në Shqipëri.

paudhë aq edhe dështak ndaj jetës dhe historisë së kulturës dhe shkencës së vërtetë e të mirëfilltë shqiptare. Por a të ka vërtet faj në gjithë këtë mesele e gjithë ajo elitë intelektuale shqiptare e Pasluftës – e cila pati fatin e pafat të gjëllinte aty, sepse ndoshta edhe s'donte t'i linte pendët vendit të vet, qoftë edhe për bindjet e veta ideologjike (!!!) – e aq më pak gjithë ato prurje të saja solide për një zgjidhje alternative të përbashkët ndaj 'Çështjes Shqiptare', një zgjidhje kjo sa e 're' në hapësirën kompakte shqipfolëse aq edhe e '(mirë)njohur' në Perëndimin e fundshekullit XIX dhe të gjysmës së parë të shek. XX?

Të mohosh rolin pozitiv të elitës intelektuale shqiptare në historinë e zhvillimit të shkencave albanologjike në hapësirën kompakte shqipfolëse është njëllë si të duash të mbulosh pa derman diellin me shoshë, pra të mos kesh mësuar ende të ndash as me dorë e as me mend grurin nga egjra e shapin nga sheqeri. Parë nga kjo perspektivë, aktiviteti intelektual dhe angazhimi social i Jubilarit tonë sikurse vetë ky tubim që i përkushtohet atij fitojnë gjithnjë e më shumë kuptim.

Bibliografi

Buda, Aleks

1986 "Shkrime historike" (bot. Stefanaq Pollo), bl. 1-2, Tiranë.

2006 "Studime historike" (bot. Hivzi Islami et al.), Prishtinë.

Demiraj, Bardhyl

2012: Mallkimi i epirotit (1483); në: „Hylli i Dritës” 1 [2012] 27-37, Shkodër.

2014: Shqiptar dhe shqa. Histori popujsh përmes dy emrave etnikë, Naimi, Tiranë.

2015: Shqipëria dhe shqiptarët në oborrin e Habsburg-ut – një rast i parë i ndërlikjes së shkencës me politikën; në: „Seminari XXXIV ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. Prishtinë më 17-28 gusht 2015”, bl. 34/1 15 – 26, Prishtinë.

2016: Damnatio memoriae vs. laudatio funebris – dy shfaqje të 'tranzicionit' intelektual në Enciklopedinë Shqiptare, në: "Milosao" – Supplement i "Gazeta shqiptare" nr. 239 (26.06.2016), S. 1-5; und nr. 240 (03.07.2016), S. 2-5.

Demiraj, Shaban

2008: Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët; Tiranë.

Egro, Dritan

2007: Historia dhe Albanologjia. Një qasje kritike studimeve osmane në historiografinë moderne shqiptare (nga gjysma e dytë e shek. XIX deri me sot); Tiranë.

Frashëri, Kristo

2008 Historia e qytetërimit shqiptar (Nga kohët e lashta deri në fund të Luftës së Dytë Botërore), Tiranë.

Gostentschnigg, Kurt

1999: Die Verflechtung von Wissenschaft und Politik am Beispiel der österreichisch-ungarischen Albanologie; në: "Südost-Forschungen" 58 [1999] 221-245.

- 2006/7: Albanerkonvikt und Albanienkomitee. Instrumente der Handels- und Verkehrspolitik -Österreich-Ungarns gegenüber Albanien im Dienste des informellen Imperialismus; në: "Südost-Forschungen" 65/66 [2006/7] 313-337.
- 2012: Johann Georg von Hahn dhe albanologjia austro-hungareze midis shkencës dhe politikës; në: Johann Georg von Hahn. Akten der Internationalen Konferenz "Nga Gjermanistika në Albanologji: Johann Georg von Hahn, themeluesi i albanologjisë me rastin e 200-vjetorit të lindjes"; seria "Albanische Universitätsstudien (vormals Elbasaner Universitätsstudien)" Sonderband 1; Oberhausen.
- 2014: (& Karl Kaser): Albanologjia austro-hungareze 1867-1918 – një rast i imperializmit kulturor? Një projekt kërkimor; në: "Hylli i Dritës" 1-2 [2014] 3-27.
- Hirsch, Eike Christian
2000: Der berühmte Herr Leibniz. Eine Biographie, München.
- Ölberg, Hermann (bot.)
1972 Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquiums zum Gedächtnis an Norbert Jokl (Innsbruck 28. Sept. - 3. Okt. 1972) Innsbruck 1977.
- Schmitt, Oliver Jens
2005: "Der Genosse Aleks und seine Partei oder: Zu Politik und Geschichtswissenschaft im kommunistischen Albanien (1945-1991)"; në: "Beruf und Berufung. Geschichtswissenschaft und Nationsbildung in Ostmittel- und Südosteuropa im 19. und 20. Jahrhundert" (bot. Markus Krzoka, Hans-Christian Maner). Münster.
- 2009: Skanderbeg. Der neue Alexander auf dem Balkan, Friedrich Pustet – Regensburg.
- 2010: Einleitung, në: (A. Mosser bot.) Religion und Kultur im albanischsprachigen Südosteuropa, Peter Lang – Wien et al. f. 7-13.
- 2012: Albanische Geschichte als Balkangeschichte, në: "Studime për nder të Rexhep Ismajlit - me rastin e 65-vjetorit të lindjes" (bot. Bardh Rugova) Prishtinë, 2012, S. 685-705.
- Vehbiu, Ardian
2007: Obsesioni me origjinën (nga A. V.: 7 korrik 2007) në <https://peizazhe.com/2007/07/09/obsesioni-me-origjinen/>

Abstract

Paradigm changes in Albanian Studies and their reflection in statehood myths in the compact Albanian speaking area

The object of this paper is essentially the "Albanian Question", viewed in time and space as a problematic vortex within the matrix of ethnic-linguistic culture, which once conditioned the acquisition of Historical Albanian Studies as a regional complex science that accompanies the professional and intellectual Albanian debate nowadays. This paper will mainly be focused on the changes of scientific paradigm

witnessed by this debate in regard with the investigation of this question during the second half of the XXth century, concretely through inclusion of its coherent results (Buda, Çabej, Domi, Demiraj, Bokshi, Ismajli) in mythical and historical mosaic of state propaganda, gripped by a kind of 'Illyrian-mania' delirium in the Albanian ethnic culture.

Democratic change in Albania in the 90s of last century, followed by the state creation process in Kosova as well as other positive developments in the Albanian-speaking area in the Balkans, has driven, in a way or another, even some transition in contemporary professional and intellectual debate, where the former 'Illyrian-mania' threatens to wither up by 'Illyrian-phobia'. To what extent follows this process a potential paradigm change and what value the to-date science achievements in the Albanian history in the second half of the century XX do preserve, are these two issues, by which the author will conclude his speech.